



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. _91___ prot.

Elbasan, më 17.03.2020

UDHËZIM

Nr. __1__, datë 17.03.2020

PËR

ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË FAKUTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 43, të Statutit të Universitetit "A. Xhuvani", miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UE-së Nr.5 datë 30.01.2018, Neni 19, si dhe në zbatim të Vendimit të Rektorit të UE-së, datë 17.03.2020 "Për zhvillimin e procesit mësimor online në Universiteti e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", dhe Udhëzimit përkatës të MASR, Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, pas diskutimit më datë 17.03.2020 mbi mundësitë e përdorimit të formave alternative për zhvillimin e mësimdhënies online, të propozuara nga departamentet përkatëse,

UDHËZON:

1. Zhvillimin e procesit mësimor online në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, duke filluar më datë 17.03.2020, për një periudhë të pacaktuar, deri në fillimin e procesit mësimor me prezencë në auditore.
2. Zhvillimi i procesit mësimor online do të realizohen si më poshtë:
 - 2.1. Pedagogët e departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, sipas veçorive të lëndëve që zhvillojnë dhe ngarkesës mësimore të parashikuar për semestrin e dytë, të vitit akademik 2019-2020, do të zgjedhin vetë, me dijeni të drejtuesit të departamentit, përdorimin e një prej formave online të komunikimit në grup, si më poshtë:

- ✓ Google Clasroom
- ✓ Moodle
- ✓ WhatsApp
- ✓ Viber
- ✓ E-mail
- ✓ Facebook
- ✓ Skype
- ✓ Video conference
- ✓ Video call
- ✓ Zoom meeting
- ✓ Etj..



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

3. Për zhvillimin e mësimit online, çdo pedagog do të respektojë procedurat si më poshtë:
 - 3.1. Krijon grupin virtual të programit të studimit me studentët e grupit, sipas planit mësimor. Grupi virtual i studimit krijohet me të gjithë, ose më shumicën e studentëve të atij grupi studimi.
 - 3.2. Jep udhëzime, materiale, leksione në formate të ndryshme për grupin e krijuar, lidhur me përvetësimin e lëndës përkatëse. Formatet e materialeve mund të jenë në "word", "pdf", "power point", "excel", etj.
 - 3.3. U përgjigjet pyetjeve të studentëve për çështje të ndryshme të mësimit.
 - 3.4. Jep detyra dhe ushtrime lidhur me lëndët në varësi të veçorive të secilës lëndë.
 - 3.5. Ndjek ecurinë e përgatitjes së detyrave të kursit, si dhe ecurinë e studentëve me përgatitjen e tezës së diplomës.
 - 3.6. Informon drejtuesin e njësisë bazë për ecurinë e zhvillimit të mësimit online.
 - 3.7. Dokumenton zhvillimin e mësimit në evidencat përkatëse sipas orarit.
4. Personeli ndihmës-akademik do të mbështesë dhe lehtësojë zhvillimin procesit mësimor online lidhur me nevojat për seancat e punëve laboratorike.
5. Ngarkohen drejtuesit e departamenteve të FSHN-ës për ndjekjen e zbatimit të këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof.Dr. Sotir MALI